



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 72, datë 01.10.2018**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM  
TARIFE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME KRUIJË**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura*" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura*" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura*" (**Vendimi nr. 42**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 01.10.2018 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

**Konstatoi se:**

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Krujë është licencuar me vendimin e KKRR nr. 18, datë 05.05.2017, "*Për licencimin e Ujësjetllës Kanalizime Krujë*" pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në piken 3, të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "*Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*".

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Krujë ka aplikuar pranë ERU me shkresën nr. 1252 prot. datë 28.06.2018, me lëndë "*Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm*".

dhe kanalizime" bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Krujë kishte mangësi në dokumentat "Pasqyrat Financiare 2017" dhe "Raporti i Ekspertit Kontabël".

ERRU ju drejtua shoqërisë me shkresën nr.337/2 prot, datë 20.07.2018 për plotësim të dokumentacionit të mësipërm.

Shoqëria UK Krujë me shkresën nr. 1447 prot, datë 18.09.2018 ka dërguar dokumentacionin e munguar "Pasqyrat Financiare 2017" dhe "Raporti i Ekspertit Kontabël".

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Krujë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Krujë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Teknike Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Krujë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Ndriçim Shani**